# Drive

PORSCHE
ALBANIA

06/18


04 **Në kreshtën e teknologjisë** *In the forefront of Technology*

06 **Tension i lartë** *High voltage*

14 **Tërësisht i ri** The all new


LETËR 100% E RICIKLUAR
100% RECYCLED PAPER

# Përmbajtja

## *Content*


**E-Crafter: Tension i lartë**
High voltage

06

**New A6**

08

**CUPRA: Një markë e re ka mbërritur**
*CUPRA: A new brand has arrived*

10

**Touareg: Tërësisht i ri**
*Touareg: The all new*

14

**GTI Wörthersee Treffen**
*GTI Wörthersee Treffen*

20

Revista Drive është një botim periodik i Porsche Albania.
Realizimi: Botues Porsche Albania,
Realizimi grafik: Sourceone

Burimi: Audi: Audi-Mediaservice.com,
SEAT: media.SEAT.com,
Volkswagen Makina Tregtare: volkswagen-media-services.com,
Volkswagen Magazine
ŠKODA: press.ŠKODA-auto.com.



Për komente, pyetje apo sygjerime ju lutem na kontaktoni në office@porsche.al ose në numrin e telefonit: +355 (04) 240 74 30.

Porsche Albania,
Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 7, Rr. Monun.
Telefon: +355 (04) 240 74 30,
Fax.: +355 (04) 240 74 34,
e-mail: office@porsche.al; http://www.porsche.al

# I dashur lexues,

# *Dear Reader,*

**Dorian Mehmeti** - Drejtor Marketingu Porsche Albania
*Marketing Manager Porsche Albania*

Takimi veror i revistës Drive, i cili këtë vit përkon edhe me Kampionatin Botëror të futbollit, do të sjellë tek ju një pasqyrë të plotë të aktiviteteve që Porsche Albania ka patur në 6 muajt e parë të 2018.

Sportdashësit në Tiranë kanë patur mundësi të ndjekin ndeshjet e skuadrës së zemrës në sheshin më qendror të Tiranës, Sheshin Skënderbej. I njëjti shesh, vetëm disa muaj më parë, do të priste prezantimin e modelit më të ri nga shtëpia Çeke e prodhimit të makinave, ŠKODA Karoq (Karok). Nën një kupolë moderne u mblodhën, klientë, miq e të apasionuar pas këtij segmeti për të parë për herë të parë SUV-in e ri nga ŠKODA.

Në Mars 2018, Audi i ri A8 debutoi gjithashtu përpara publikut Shqiptar në shtëpinë Audi në Porsche Albania, në një aktivitet ku teknologjia më e mirë Gjermane takon entuziastët shqiptarë të Audit.

Dhe vetëm para pak ditësh, Volkswagen në Porsche Albania, prezantoi SUV-in më energjik të markës, Touareg-un e ri. Një model, i cili premton jo vetëm të rrëmbejë shikime në rrugë, por të sjellë një përvojë tërësisht të re në udhëtim.

Ofensiva elektrike nga Volkswagen vazhdon, ku disa flota makinash elektrike kanë marrë përsipër misionin e madh për t'a mbajtur qytetin më të pastër kilometër pas kilometri.

Fushatat e vazhdueshme në servis u kanë ardhur më afër klientëve tanë, me shërbime si mirëmbajtje apo riparime, duke siguruar vazhdimësinë pa ndërprerje të udhëtimit të tyre.

Por ritmi i lartë i aktiviteteve në gjysmën e parë të vitit, do të vazhdojnë edhe në gjysmën tjetër të tij, ku modele të reja si Audi A6 apo ikona Audi Q8 do të zbarkojnë për herë të parë në rrugët Shqiptare.

Për të reflektuar tërë këto risi, por edhe ambiciet e kompanisë, Porsche Albania këtë vit ka alokuar edhe buxhetin më të madh të marketingut të këtyre 13 viteve aktivitet në treg.

Risitë nga bota Volkswagen kanë zënë faqet e revistës, ku me kënaqësi do të veçoja Crafterin e ri Elektrik nga Volkswagen Makina Tregtare. Partneri i ditës tuaj të punës tashmë vjen edhe me 0 emetime në rrugët e qytetit.

Këto e shumë më tepër në faqet në vijim,
Lexim të mbarë.

The summer meeting with Drive magazine, which this year coincides with the football World Cup will bring you a full overview of activities that Porsche Albania had during the first half of 2018.

Sport lovers in Tirana have had the opportunity to watch their teams' matches in Tirana's central Scanderbeg Square. The same square, only a few months ago saw the unveiling of the newest model from the Czech car maker, the new ŠKODA Karoq. Under a modern dome, customers and those passionate about this segment gathered to take a look for the first time at the new SUV from ŠKODA.

In March 2018, the new Audi A8 also debuted before the Albanian public in the Audi home at Porsche Albania, at an event where the best German technology meets Albanian enthusiasts of Audi.

And only a few days ago, Volkswagen at Porsche Albania introduced the brand's most energetic SUV, the new Touareg. It is a model that promises not only to turn heads on the road but also to bring an entirely new driving experience.

The electrical offensive by Volkswagen continues with some electric car fleets taking over the major mission of keeping the city cleaner after each driven kilometer.
The continuous campaigns at the service shop have stood by our customers, with services such as maintenance or repairs, ensuring that their ride is uninterrupted.

The high pace of activities in the first half of the year will continue also during the second half, with new models such as Audi A6 or the iconic Audi Q8 landing for the first time in Albanian roads.

To reflect all of these novelties, as well as the company's ambitions, Porsche Albania this year allocated the highest marketing budget of the last 13 years of activity in the market.

Novelties from the Volkswagen world have arrived at the magazine pages, where I would point out to the new electric Crafter by Volkswagen Commercial Vehicles. The partner of your workday now comes with 0 emissions in the city streets.

You may find these and much more in the following pages.
Happy reading.

# Në kreshtën e teknologjisë

## Prezantimi i Audit të ri A8, në Shqipëri.

# *In the forefront of Technology*

## *The introduction of the new Audi A8 in Albania.*

Më 27 Mars 2018, salloni Audi mirëpriti entuziastët e markës me katër rrathë, të cilët patën rastin të shohin të parët debutimin e modelit më luksoz, Audit të ri A8 në Shqipëri.

"Audi i ri A8, produkti më i fundit i teknologjisë Gjermane, vjen sot më: teknologjik, komod, inteligjent dhe i sigurtë se kurrë më parë." U shpreh në fjalën e hapjes Drejtori i Përgjithshëm i Porsche Albania-s, Z. Gentian Bushati.

I konceptuar si modeli me nivelin më të lartë të pavarësisë në rrugë, Audi i ri A8 ngre siparin e një ofensive të pasur modelesh elektrik dhe me shkallë të lartë pavarësie në rrugë.

"Një gamë e gjerë modelesh, ku përfshihen edhe makinat elektrike me pavarësi deri në 600 km, do të jenë pjesë e ofertës Audi në këto dy vite." – vijoi më tej Z. Bushati.

Prezantimi i A8, tipareve, dizajnit, teknologjisë dhe nivelit të sofistikimit, kësaj rradhe ju besua një profesionisti në fushën e dizajnit: Dr. Ledian Bregasi-t, Dekani i departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit në universitetin Polis si edhe Drejtor i Unionit të Arkitektëve të Shqipërisë.

Prezantim i detajuar i modelit i la rradhën publikut për të parë nga afërt modelin me të gjithë tiparet dhe sofistikmin e markës Audi.

**Audi Intelligence**

Me AI traffic jam pilot, Audi prezanton për të parën herë një sistem pilotimi automatik që arrin nivelin 3. Me ndihmën e sensorëve më ultratinguj, kamera dhe skanim laser, sistemi mund të marrë përsipër kontrollin e makinës në autostradë apo rrugë ndërqytetase në momente trafiku deri në 60km/orë, duke startuar nga vendi, përshpejtuar drejtuar dhe frenuar brenda korsisë përkatëse.

Në nivelin e 3 të autonomisë, drejtuesi i mjetit nuk e ka të nevojshëm monitorimin e vazhdueshëm të udhëtimit. Sistemi njeh në mënyrë autonome limitet – konkretisht situatën ku kushtet e ambientit përreth nuk përputhem me gamën e funksioneve të sistemit. Në këto raste, makina njofton drejtuesin e mjetit, disa sekonda përpara, të rimarrë kontrollin e makinës.

> March the 27th marked a special day for the Audi enthusiast in Albania. When gathered at the Audi Showroom, they had the chance to be among the first to see the unveiling of the brand's most luxurious model the new Audi A8.

"The new Audi A8 the forefront of the German technology, could be defined as the most, advanced, luxyrious, intelligent Audi ever" - said in his opening speech Mr. Gentian Bushati, General Manager of Porsche Albania

Boasting the highest level of driving autonomy the new Audi A8 marks the beginning of the brand rich offensive of both electrical and autonomous models.

„A wide model range that includes electrical models with a range of up to 600 km will be part of what Audi will offer in the next two years" – continued Mr. Bushati.

The introduction of the new Audi A8, its features, technology and level of sophistication was entrusted to a professional in the field of design. Dr. Ledian Bregasi, Dean of Architecture and Design at Polis University and Head of the Albanian Union of Architects, lead the unveiling of the model in Albania.

After the detailed model presentation and unveiling the evening participants had the chance to see first hand all what this new model has to offer.

**Audi Intelligence**
With AI traffic jam pilot, Audi introduces level 3 of autonomous driving, the highest level currently on road. With the support of its ultrasound, camera and laser scanning the system can take over driving in highways or interstates roads with speeds up to 60 km/h. This includes breaking, steering and acceleration within the lane.

In level 3 of piloted driving, the driver no longer has to continuously monitor and can carry out other activities supported by on-board equipment. The system autonomously recognizes the limit – that is, the point at which the ambient conditions no longer match the range of functions of the system. In these cases, the vehicle prompts the driver to take over the task of driving the vehicle, with several seconds advance warning.

# Tension i lartë

## High voltage

Në dekadat e fundit, hopet teknologjike përsa i përket mënyrës së të udhëtuarit kanë qenë minimaliste. Motorë më të fuqishëm, sisteme më të përparuara kontrolli emetimesh, dizajn më agresiv e shumë ndryshime 'kozmetike' në paraqitje. E megjithatë përparimi në fushat e tjera dukej si i pakapshëm për industrinë e makinave. Por sot vizionarë të industrisë po sjellin ndryshime rrënjësore në mënyrën e të udhëtuarit. Udhëtimi autonom, sistemet më të përparuara të sigurisë e teknologjia e motorëve elektrik janë vetëm disa nga rezultatet e progresit teknologjik të kësaj industrie.

**e-Crafter**

Energjia elektrike prej disa vitesh tashmë është përdorur si karburanti më i ri i makinave të pasagjerëve. Por pyetjes sesi kjo teknologji do të debutonte në tregun e makinave tregtare, inxhinierët Gjerman i dhanë përgjigjen më të mirë, ajo quhet: e-Crafter.

Modeli elektrik është projektuar në bashkëpunim me klientët - në veçanti për ato automjete, të cilët mbulojnë 70 deri në 100 km në ditë, ku gjatë udhëtimit përfshihen shumë ndalesa dhe rinisje. Këto parametra zbatohen në rreth 85% të udhëtimeve të bëra në një mjedis urban, sipas analizës së më shumë se 210,000 profileve të drejtimit me mbi 1,500 konsumatorë.

E-Crafter përqafon motorët elektrik prej 100kW - ekuivalent me 136 kuaj fuqi. Fuqizuar nga një bateri litiumi që është plotësisht e integruar në pjesën e poshtme të trupit të makinës, që do të thotë se vëllimi i ngarkesës së modelit elektrik është standard (10.7 m3) dhe është plotësisht i përdorshëm. Me një performancë të mahnitshme për një makinë tregtare: shpejtësia maksimale është 90 km/h dhe është në gjendje të përshkoi 160 km me një karikim.

Sipas prezantimit në "Commertial Vehicle Show" modeli ka një vëllim ngarkese 10.7 m3, ndërsa Volkswagen premton se do të vihen në dispozicion edhe për ngarkesa që kapin shifrat 1-1.75 ton. Duke përdorur një stacion të ngarkimit të shpejtë të baterisë e-Crafter mund të ngarkohet në 80% për vetëm 45 minuta. Një "wallbox" më pak i fuqishëm në shtëpi ose zyrë arrin 100% karikim në 5.5 orë. Me fjalë të tjera, afërsisht njësoj si në çdo makinë tjetër elektrike.

Në 'Commercial Vehicle Show', drejtori i Makinave Tregtare Volkswagen, Carl zu Dohna shtoi: "Premtimi ynë për të punuar me të gjithë klientët dhe për t'i pajisur me zgjidhje të lëvizshmërisë dhe për t'i mbajtur ata dhe bizneset e tyre gjithmonë një hap përpara, është në zemër të gjithçkaje që ne bëjmë. Të paturit të makinave të duhura është thelbësore për ne dhe jemi të sigurt se e-Crafter do të luajë një rol të rëndësishëm në strategjinë tonë për modelin e ardhshëm të lëvizshmërisë".

Shitjet europiane të e-Crafter do të fillojnë në shtator 2018 – me pretendimin që të gjitha sprovat të përfundojnë me sukses, pra pasi të jetë testuar mjaftueshëm në praktikë dhe të jetë bërë plotësisht gati për tregun. Nuk na mbetet gjë tjetër veçse të presim modelin që do revolucionalizojë lëvizshmërinë e makinave tregtare.

Elion Gjoka
Drejtor Volkswagen Makina Tregtare

In the last decades, the technological leaps in the field of mobility have been minimal. More powerful engines, more advance emission systems, a stronger design language and 'cosmetics' improvements in the vehicle appearance. Compared to the developments made in other fields the automotive industry was lagging behind. Today industry visionaries are introducing a completely new mindset in the way we travel. Autonomous driving, state of the art safety systems and the electric engine technology are just a few of the technological results of this industry offensive.

**e-Crafter**

Since a few years now electric energy has been the new fuel of a range of passenger vehicles. The question of how this technology would be introduced to the commercial vehicles, the German engineers have answered in the best way possible: the e-Crafter.

The electric model has been projected in collaboration with customers – particularly those vehicles that cover 70 to 100 km per day, with the trip involving many stops and restarts. These parameters are used in about 85% of the trips done in an urban environment, according to analysis of more than 210,000 driving profiles with over 1,500 customers.

The E-Crafter abandons diesel engines to move on to electric ones with 100kW – equivalent to 136 hp. Powered by a lithium battery that is fully integrated in the part under the body of the van, which means that the volume of the electric model is standard (10.7 m3) and is fully usable. There is a stunning performance for a commercial vehicle: maximal speed is 90 km/h and it can run for 160 km on one charge.

According to the introduction of the model at the "Commercial Vehicle Show," the model has a loading surface of 10.7 m3, while Volkswagen promises to make available types also for loads reaching 1-1.75 tons. Using a fast battery charging station, the e-Crafter can charge up to 80% in only 45 minutes. A less powerful "wallbox" at home or in the office reaches 100% charge in 5.5 hours. In other words, it is almost like any other electric vehicle.
In the Commercial Vehicle Show, the head of Volkswagen Commercial Vehicles, Carl zu Dohna added: "Our promise to work with all customers and provide them with bespoke mobility solutions to keep them and their businesses moving is at the heart of everything we do. Having the right vehicles, including alternatively fueled vans, is essential and we are sure the e-Crafter will play an important part in our future mobility model strategy."

European sales of the e-Crafter start in September 2018 – with the expectation that all tests conclude successfully, i.e. after being tested sufficiently in practice and being fully ready for the market. There is nothing left to do but wait for the model that will revolutionize the mobility of commercial vehicles.

Elion Gjoka
Volkswagen Commercial Vehicles Brand Manager

Për të gjithë ata që në jetë nuk lakmojnë ekstremet, por kërkojnë të mesmen e artë, apo e thënë ndryshe: i duan të gjitha gjërat në një, sot ka një alternativë: është Audi i ri A6!

Nëse A8 reflekton shumë prestigj dhe sofistikim, ndërsa A7 me siluetën e saj dinamike nuk e fsheh dot karakterin e dukshëm sportiv, A6 e re qëndron në mes. “Qëllimi ynë ishte të ndërtonim makinën më progresive dhe sportive në këtë segment dhe besoj se këtë e kemi arritur!”- do të shprehej dizenjatori Philipp Roemers. Audi i ri A6 është ndërthurja e ecjes sportive, udhëtimit të rehatshëm, hapësirës së bollshme, dizajnit të veçantë dhe teknologjisë më të avancuar.

Silueta e njohur dhe parafangot muskuloze, që të rikujtojnë quattro-n historike, citojnë elemente të trashëgimisë së markës. Raporti i dritareve me trupin e makinës si dhe trekëndëshi përmbyllës janë gjithashtu detaje të njohura. Grila gjashtëkëndëshe, fenerët LED para dhe fenerët e bashkuar me një shirit kromi pas, mbeten elementët optik më dominant. Dimensionet kanë ndryshuar minimalisht, 7 mm në gjatësi dhe 12mm distancë aksiale. Pavarësisht përshtypjes së një coupe-je të madhe, tavani krijon më shumë hapësirë për pasagjerët si në lartësi ashtu edhe në gjerësi. Volumi i bagazhit prej 530 litra mbetet i pandryshuar.

For all those who don’t strive for extremes but look for the golden middle, or in other words: want everything in one, there is now a new alternative: the new Audi A6!

While the A8 reflects more prestige and sophistication, and the A7 with its dynamic silhouette cannot hide the evident sporty character, the new A6 is in the middle. “Our goal was to build the most progressive and sporty car in this segment and I believe we have achieved that!” said designer Philipp Roemers. The new Audi A6 is the merging of the sporty ride, the comfortable travel, ample space, special design and the most advanced technology.

The known silhouette and the muscular benders that remind one of the historical Quattro, quote elements the brand’s legacy. The window and car body ratio and the closing triangle are also known details. The hexagonal grille, LED headlights and backlights connected with a chromium stripe remain the most dominant visual elements. Dimensions have changed minimally, 7 mm in length and 12 mm in axial distance. In spite of the impression of a large coupe, the ceiling creates more space for passengers both in height and width. The luggage volume of 530 l remains unchanged.

Tërësisht e rikonceptuar shfaqet pjesa e brendshme: Sedilje tepër të rehatshme, ku nuk mungojnë opsione që dikur i përkisnin makinave superluksoze, si personalizimi apo masazhi, dizajn futurist i kroskotit me linja të qeta dhe material cilësor. Të gjithë instrumentët analogë i kanë liruar vendin ekraneve dixhitale. Virtual cockpit, dy ekrane Touch dhe shumë opsione të reja e kategorizojnë A6 në klasin e lartë. Një ekran 8.6 inch zëvendëson butonat e klimatizimit dhe rregullimit të sediljeve. Një ekran tjetër 10.1 inch shërben për të naviguar në menunë e opsioneve të pafundme. Në kombinim me Virtual cockpit 12.3 inch dhe raportimin haptik dhe akustik (imitimin e zhurmave origjinale të tastave) duket se epoka e butonave dhe instrumentëve analogë ka perënduar…

Përveç elementeve optike, modeli i ri ka përfituar shumë nga A8 edhe në teknologji. A6 e re ofron gjeneratën më të avancuar të infotainment (MMI touch response), sistemin e sensorëve që mundësojnë ecjen autonome deri në nivelin 3 si dhe sistemet e hibrideve të buta. Sistemi i drejtimit progresiv, diferenciali sportiv dhe drejtimi i katër rrotave shtojnë dëshirën për kilometra të pafundme.

Sistemet e asistencës numërojnë mbi 30 opsione, të grupuara në paketat “City”, ”Tour” dhe ”Park”. Për të siguruar një funksionim sa më të saktë të sensorëve dhe kamerave të ndryshme, është menduar edhe për një impiant të veçantë pastrimi sensorësh.

Janë të shumta detajet dhe risitë që do të donim t’i ndanim me ju, por lista është e gjatë. Ndoshta vlen më mirë të presim fundin e verës, kur A6 e re të jetë e disponueshme edhe për një test-drive!

The interior appears completely redesigned: very comfortable seats, with options that once belonged to only super luxury cars, such as personalization or massage, futuristic dashboard design with calm lines and quality material. All analogue instruments have made way for the digital screens. The virtual cockpit, two touch screen displays and many new options characterize the new A6 in the higher class. An 8.6 inch screen replaces climate control and seat adjustment buttons. Another 10.1-inch screen is for navigating the endless menu of options. In combination with the 12.3 inch virtual cockpit and the haptic and acoustic raport (imitating the original button click noise) it seems the era of buttons and analogue instruments has set…

Besides the optic elements, the new model has earned a lot from the A8 also in technology. The new A6 offers the most advanced generation of infotainment (MMI touch response), the sensor system that enables autonomous driving up to level 3 and the soft hybrid systems. Progressive steering, sporty transmission and the four-wheel drive add to the desire for endless kilometers.

Assist systems include over 30 options, grouped in the City, Tour and Park packages. To ensure an accurate functioning of sensors and the various cameras, a special sensor cleaning system has been included.

There are many details and novelties we would like to share with you but the list is long. Maybe it is better to wait for the end of the summer, when the new A6 will be available also for a test drive!

# New A6

# CUPRA
# Një markë e re ka mbërritur

Në 22 shkurt të këtij viti, SEAT lajmëroi hedhjen në treg të CUPRA-s, markës më të re sportive të makinave. Lajmërimi u bë gjatë një eventi të veçantë në Terramar të Spanjes. Marka shfrytëzoi këtë mundësi edhe për të prezantuar modelin e parë, CUPRA Ateca SUV.

CUPRA ka qenë gjithmonë sinonimi i sportivitetit të markës SEAT. Tashmë, do të ekzistojë si një markë më vete. E thënë thjeshtë, është një markë e re e krijuar për të zhvilluar modele përkrah SEAT me qëllimin për t'u rritur në mënyrë të pavarur. Kjo do të thotë që CUPRA do të ketë vendin e saj në koncesionar të caktuar nëpër Evropë.

CUPRA nënkupton ekskluzivitet, sofistikim dhe performancë. Është një markë për ata që zgjedhin të përjetojnë jetën sipas mënyrës së vet. Për ata që duan të krijojnë rrugën sipas mënyrës së tyre. Sipas fjalëve të CEO-s së SEAT Luca de Meo, "Ky projekt lindi si ëndrra e një grupi njerëzish që kërkojne të bëjnë për vete një grup të ri të apasionuarish për makinat".

Duke gërmuar më thellë, zbulojmë se CUPRA bazohet në 4 kolona kryesore. Garazhi, që fokusohet te makinat sportive dhe aksesorët ekskluzivë. Garimi, divizioni që do të trajtojë mjetet e garave. Lifestyle, për aktivitete dhe eksperienca drejtuar një komuniteti që do të afrojë klientë të rinj. Logo e markës së re sportive përmban elemente nga bota e artizanatit dhe garave duke sjellë një pamje dinamike dhe të pagabueshme CUPRA.

Për sa i përket strukturës, CUPRA do të jetë pjesë e SEAT ashtu si kompani të tjera si SEAT Metropolis: Lab Barcelona. Nëpërmjet këtij plani, qëllimi është diversifikimi i biznesit dhe zhvillimi i suksesshëm i modeleve të reja për të fuqizuar më tej kompaninë. Për më tepër kompania e re do të kujdeset për divizionin e garave.

**Lindur dhe ndërtuar nga bashkëpunime të forta**
Për të transmetuar përkushtimin ndaj zejtarisë, pasionit, cilësisë së lartë dhe individualizmit, CUPRA ka lidhur marrëveshje me punishte ekskluzive si L.G.R., TRAKATAN dhe FABIKE për të zhvilluar produkte të limituara në sasi. Kompania do të bashkëpunojë edhe me DAINESE, NINCO dhe marka të tjera për të mbështetur pasionin e saj për garat, teknologjinë dhe inovacionin.

**Modeli i parë, CUPRA Ateca**
Si SUV, CUPRA Ateca është një model unik në segment, duke qenë se ofrohet vetëm nga marka premium. Me 300 kuaj fuqi, 4Drive (4x4) dhe një kambio të re DSG, Ateca arrin 0 to 100km/h për vetëm 5.4 sekonda. Modeli ofron një balancë që jo shumë makina e ofrojnë, preçisionin dhe sportivitetin të kombinuara me përdorimin e përditshëm.

**CUPRA TCR, garat dhe projektet e ardhshme**
CUPRA TCR do të jetë makina e parë e garave e kësaj marke. Do të garojë zyrtarisht në garat TCR të këtij viti. Për më tepër, marka po punon mbi modelet e reja CUPRA Ibiza dhe CUPRA Arona. Gjithashtu në plan është edhe një model krejtësisht i ri në segmentin CUV.

# CUPRA
# A new brand has arrived

On February 22 this year, SEAT announced the launching in the market of CUPRA, the newest sports brand of cars. The announcement was made at a special event in Terramar, Spain. The brand used the opportunity to present the new model CUPRA Ateca SUV.

CUPRA has always been a synonym for the sportiveness of the SEAT brand. Now, it will exist as a separate brand. Simply said, it is a new brand created to develop new models alongside SEAT for the purpose of growing independently. This means that the CUPRA will have its own place in certain dealers through Europe.

CUPRA stands for uniqueness, sophistication and performance. It is a brand for those who choose to experience life on their own terms. For those who need to create the path. As Luca de Meo put it “The whole project surfaced as the dream of a group of people looking for a way to conquer a new group of car lovers”.
Digging deeper into the brand, it is built on four fundamental pillars. Garage, focusing on sportive street cars and exclusive accessories. Racing, the division that will look after competition cars. Lifestyle, for partnerships and collaborations. And Experiences, a community that will bring together future customers.

In terms of structure, CUPRA will be part of SEAT the same way as other wholly-owned companies, such as SEAT Metropolis: Lab Barcelona. Through this arrangement, the plan is to diversify business and develop successful new models in order to strengthen the company. Moreover, the new firm will take over the entire motorsport and racing division.

**Born and built with strong partnerships**
In order to transmit commitment to craft, passion, high quality and individualization, CUPRA has partnered with small studios and workshops such as L.G.R., TRAKATAN and FABIKE to develop exclusive and limited-edition products. The new car firm will also collaborate with DAINESE, NINCO and other brands to support its passion for racing , technology and innovation.

**First model, CUPRA Ateca**
As an SUV, the CUPRA Ateca is a unique model in its segment, no longer offered by premium brands only. With 300 hp, 4Drive (4x4), and a new 7-speed DSG gearbox, the new Ateca can go from 0 to 100 km/h in only 5.4 seconds. The model brings a balance than not many others offer: precision and sportiness combined with ease of use for everyday life.

**CUPRA TCR, racing and future projects**
The CUPRA TCR will be the brand’s first racing car. It will officially compete in the TCR series in the 2018 season. Furthermore, the brand has carried out design exercises on the CUPRA Ibiza and CUPRA Arona. Plans also include an entirely new model in the SUV segment.

## Nga ëndrra për një makinë, në makinën e ëndrrave tuaja!

Me Grupin Financiar të Porsche Albania, mund të keni makinën e ëndrrave tuaja, duke përshtatur kështin mujor sipas mundësive tuaja dhe të keni të gjithë fleksibilitetin që ju duhet, në kostot e mirëmbajtjes dhe të sigurimit të automjetit.

Kontaktoni me ekspertët të Volkswagen, AUDI, ŠKODA, SEAT, Volkswagen Makina Tregtare, DasWeltAuto, për të vendosur për një ofertë financimi të përshtatshme, me Porsche Finance Group Albania !!

**Porsche Finance Group Albania**
Autostrada Tiranë-Durrës
Km.7, Rr.Monun
Tiranë
Albania
Tel: +355 (04) 450 08 28
E-mail: info@porscheleasing.al
www.porscheleasing.al

PORSCHE
FINANCE GROUP ALBANIA

NËSE DËSHIRONI TË SIGUROHENI
**ka vetëm 1 emër...**

SIGAL UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA

# Mendo sa e thjeshtë është të sigurohesh ONLINE!



## Bli ONLINE siguracionin që të duhet nga celulari ose kompjuteri.

SIGAL UNIQA

Android Apps SIGAL UNIQA

www.sigal.com.al

Tel: +355 4 2233 308

# Tërësisht i ri

Volkswagen prezanton flamurmbajtësin e tij të ri – Touareg-un e brezit të tretë. Pajisur me lidhjen në rrjet për epokën moderne si dhe me zgjidhjet novatore të sistemeve të ndihmës, komoditetit, dritës dhe infotainment, ky model i gjithanshëm është në vend të parë në rrugën drejt të ardhmes. Edhe dizajni karakterizohet nga një dinamikë e veçantë. Me Touareg-un me dizajn progresiv, Volkswagen ofron një model, "Innovision Cockpit" i së cilës po ofron tashmë pamjen e brendshme dixhitale të së nesërmes.

**Dizajni i jashtëm – ndërtuar posaçërisht për liri**

**Ana ballore.** Ana ballore ekspresive e Touareg-ut është posaçërisht e dallueshme. Grila e kromuar solide duket sikur është prodhuar nga metali solid dhe e ndërlidhur përsosmërisht me linjat e vazhdueshme të dritave unike. Klaus Bischoff: "Donim të krijonim diçka në këtë anë ballore që nuk ishte parë ndonjëherë. Në një proçes intensiv, kombinuam elementët e kromuar të anës ballore dhe sistemin e dritave LED të Touareg-ut në mënyrë që kalimi midis dizajnit dhe teknologjisë të ndërlidheshin në diçka të re. "Novatore, ekspresive dhe e pamundur të imitohet, "kjo anë ballore e bën Touareg-un e ri një prej SUV-ve më të dallueshme në tregun global", thotë Bishoff. "Një zgjidhje e krijuar posaçërisht për liri. Synimi ynë nuk ishte asgjë më shumë dhe asgjë më pak.

**Silueta.**

Anët e trupit të Touareg duken si një velë e tendosur të cilën e fryn era. Vendndodhjet e theksuara të gomave të para si dhe anët e mirëformuara të shpatullave të pasme theksojnë superioritetin e Touareg-ut në çdo terren. Dhe ky ishte pikërisht synimi – të dizenjohej SUV-ja më superiore e klasës së vet. Linjat e kundërta të dritareve dhe linjat anësore janë me shumë stil. Linja e tavanit bie shumë në sy. Zgjatet në mënyrë të përsosur tek linjat anësore dhe përfundon në mënyrë dinamike me linjën vertikale C, e cila krijon pak kënd drejt anës së përparme.

**Përmasa të reja dhe peshë e ulur.** Krahasuar me paraardhësin, brezi i tretë u bë pakëz më i gjerë dhe më i gjatë, duke u bërë edhe më i sheshtë. Përmasat e reja: 4,878 mm gjatësi (+77 mm), 1,984 mm gjerësi width (+44 mm) dhe 1,702 mm lartësi (-7 mm). Rritja në gjatësi dhe gjerësi së bashku me lartësinë e pakësuar lehtas, kanë çuar në përmasa shumë më dinamike. Përmasat e reja kanë një ndikim pozitiv tek përmasat si dhe tek hapësira e brendshme. Rritja në gjatësinë e jashtme çon në një rritje domethënëse në vëllimin e bagazhit, për shembull, nga 697 në 810 litra (me sediljen e pasme ngritur). Pavarësisht rritjes së gjatësisë dhe gjerësisë, trupi i prodhuar nga ndërtimi i përzier i aluminit (48 përqind) dhe çelikut të teknologjisë së lartë (52 përqind), është 106 kg më i lehtë se paraardhësi.

**Argëtimi, Komoditeti & Siguria – Teknologji e së ardhmes**

Kabina e dixhitalizuar. Një prej shumë novacioneve të brezit të ri të Touareg është "Innovision Cockpit". Këtu ekrani 12.0-inç i instrumenteve dixhitale dhe ekrani 15-inç TFT i sistemit më të mirë Infotainment "Discover Premium", shkrihen në një njësi të re operimi, informimi, komunikimi dhe argëtimi dixhital që është gjithnjë ndezur dhe mund të kontrollohet në mënyrë intuitive dhe të personalizohet plotësisht. "Innovision Cockpit" praktikisht nuk ka asnjë buton tradicional, çelës apo levë kontrolli, por i përdor ato aty ku ka logjikë, për të siguruar funksionalitet dhe argëtim maksimal.

**Shkrirja e sistemeve të reja të ndihmës, dinamikës së drejtimit dhe komoditetit.**

Touareg-u del me gamën më të gjerë të sistemeve të ndihmës, drejtimit dhe komoditetit që ka qenë integruar ndonjëherë në një model Volkswagen. Kjo përfshin teknologji të tilla si "Night Vision" (dallon njerëz dhe kafshë në errësirë duke përdorur një kamera imazherie termale), "Traffic Jam and Roadwork Lane Assist" (drejtim pjesërisht i automatizuar dhe paralajmërim për dalje nga korsia deri në 60 km/orë, rritje shpejtësie dhe frenim), "Front Cross Traffic Assist" (i përgjigjet trafikut përpara makinës), drejtim aktiv i të gjitha rrotave (duke e bërë Touareg-un të lehtë në drejtim si makinë kompakte), "Drita IQ – Drita kryesore Matrix LED" (dritat kryesore interaktive të gjata dhe të shkurtra kontrolluar me anë të kameras) dhe një shfaqje ekrani në xhamin e përparmë. Siguri dhe komoditet i rritur për drejtuesin e mjetit dhe pasagjerët.

**Performanca.**

Volkswagen fillimisht do ta ofrojë Touareg-un e ri me motor efiçent dhe superior V6 turbo diesel (kapacitet 3.0 litra) me 210 kv/ 286 hp dhe 600 Nm që udhëton nga 0-100 km/orë në 6.1 sekonda, ndërkohë që ka konsum prej 6.9 l/ 100 km mesatarisht dhe lëshim gazrash prej vetëm 182 g/km CO2. Shpejtësia maksimale e lejuar është 235 km/orë.

> "Një zgjidhje e krijuar posaçërisht për liri. Synimi ynë nuk ishte asgjë më shumë dhe asgjë më pak"
>
> Klaus Bischoff shef i Dizajnit në Volkswagen.

# Touareg

## The all new

> Volkswagen is launching its new flagship - the third generation Touareg. Equipped with connectivity for the modern era as well as a pioneering fusion of assist, comfort, light and infotainment systems, the allrounder leads the way into the future. The design is also characterised by a special dynamic. With the progressively designed Touareg, Volkswagen offers a model whose “Innovision Cockpit” is already providing the blueprint for the digital interior of tomorrow.

**Exterior design – Tailor-made for freedom**
**Front end.** The expressive front end of the Touareg is particularly distinctive. The chromed solid grille appears to be machined from solid metal and seamlessly interwoven with the continuous lines of the signature light. Klaus Bischoff: “We wanted to create something with this front end that had never been seen before. In an intensive process, we combined the chrome elements of the front end and the new LED light system of the Touareg so that the transition between design and technology blended into a new entity.” Innovative, expressive and impossible to imitate. “This front end makes the new Touareg one of the most distinctive SUVs on the global market”, says Bischoff. “A tailor-made solution for freedom. Our goal was nothing more and nothing less.

**Silhouette.**
The sides of the Touareg body look like a stretched sail blown by a tailwind. Accentuated front wheel housings and well formed rear shoulder edges highlight the superiority of the Touareg on any terrain. And this was the goal - to design the most superior SUV of its class. The opposing window lines and character lines at the side are stylish. And the roof line is striking. It seamlessly extends on the striking side line and dynamically concludes with the C-pillar that is angled towards the front.

**New dimensions and reduced weight.**
Compared with ist predecessor, the third generation became moderately wider and longer, making it flatter. The new dimensions: 4,878 mm length (+77 mm), 1,984 mm width (+44 mm) and 1,702 mm height (-7 mm). The increase in length and width in conjunction with the slightly reduced height led to significantly more dynamic proportions. The new dimensions have a positive effect on the proportions as well as the interior space. An increase in external length leads to a significant increase in the luggage compartment volume, for example, from 697 to 810 litres (with rear seat bench put up). Despite the greater length and width, the body manufactured from a mixed construction of aluminium (48 percent) and high-tech steels (52 percent) is 106 kg lighter than its predecessor.

**Entertainment, Comfort & Safety – Technology of the future**
Digitalised cockpit. One of the many technical innovations of the new Touareg generation is the “Innovision Cockpit”. Here the 12.0-inch display of the digital instruments and the 15-inch TFT touchscreen of the top infotainment system “Discover Premium” are merged into a new digital operating, information, communication and entertainment unit that is always on and can be intuitively controlled and fully personalised. The “Innovision Cockpit” has virtually no traditional buttons, switches or controls, but uses them where it makes sense, to ensure maximum functionality and entertainment.

**Fusion of new assist, driving dynamics and comfort systems.** The Touareg launches with the widest range of assist, driving dynamics and comfort systems that has ever been integrated in a Volkswagen. This includes technologies such as “Night Vision” (detects people and animals in the dark using a thermal imaging camera) “Traffic Jam and Roadwork Lane Assist” (partly automated steering and lane departure warning up to 60 km/h, acceleration and braking), “Front Cross Traffic Assist” (responds to cross traffic in front of the Touareg), active all-wheel steering (making the Touareg easy to handle like a compact car), the “IQ.Light – LED Matrix Headlight” (interactive low beam and main beam controlled by means of a camera) and a head-up display projected directly on the windscreen (windshield head-up display). Increased safety and comfort for driver and passengers.

**Performance.** Volkswagen will initially offer the new Touareg with an efficient and superior V6 turbo diesel engine (3.0 litre capacity) with 210 kW / 286 hp and 600 Nm that travels from 0-100 km/h in 6.1 s, while having a consumption of 6.9 l/100km in average and emmiting only 182 g/km of $CO_2$. Maximum allowed speed is set at 235 km/h

# ŠKODA Karoq, zbret në Tiranë

## Sheshi Skënderbej i zgjedhur si hapësira më e bukur publike për 2018 në Çmimin e Barcelonës, ishte edhe vend prezantimi i modelit më të ri ŠKODA Karoq.

Sheshi Skënderbej, i cili u përzgjodh si Hapësira më e Bukur Publike për 2018 në Çmimin Europian të Barcelonës, vendi ku u shkruajt dhe ruhet një pjesë e mirë e historisë moderne të Shqipërise. "Një shesh sa monumental po aq edhe rastësor, informal dhe çlodhës" – do të përcaktohej nga kritiku arkitekturës Hollandezi Hans Ibelings.

Në sheshin Skënderbej, hapësirën më qendrore e Tiranës, vendin ku Shqiptarët janë tubuar në revolta apo festa, në kremtime fetare apo evente sportive, më dt. 13 Shkurt 2018 u bë vend zbulimi i modelit më të ri nga Marka Çeke, ŠKODA e re Karoq.

Një kupolë e madhe jeshile fare pranë muzeut historik kombëtar, tërhoqi vëmendjen jo vetëm të kalimtarëve në shesh por edhe të drejtuesëve të mjeteve në rrugën e Durrësit dhe të Kavajës. Të ftuarit patën rastin të shohin nga afër dhe për herë të parë në Shqipëri pasaardhësin e ŠKODA Yeti dhe vëllain e madh të ŠKODA Kodiaq, SUV-n e re ŠKODA Karoq.

Gjatë fjalimit të hapjes, Drejtori i Përgjithshëm i Porsche Albania-s bëri një përmbledhje të arritjeve kryesore të një viti më parë. "Sërish Porsche Albania, me të gjitha markat e saj, ka arritur të ruajë pozicionin e parë në tregun e makinave të reja në Shqipëri. Afërsisht 1 në çdo 3 makina të reja në vend ka dalë nga sallonet tona, në total 858 klientë kanë marrë makinën e tyre të punës apo të ëndrrave në Porsche Albania."

Për modelin foli Z. Bledar Kozma, drejtori i markës ŠKODA në Porsche Albania, i cili ndër të tjera theksoi: "Karok është një makinë tërësisht e re. Me dizajnin dinamik dhe elementët e kristaltë është produkti më i fundit i filozofisë së re të dizajnit ŠKODA".

Prezantimi i elementëve të rinj në dizajn, motorët si edhe çmimet akorduar modelit ia lanë vendin protagonistit të mbrëmjes, ŠKODA Karoq.

Pas zbulimit, të pranishmit patën rastin të shohin nga afër modelin, i cili premton të vazhdojë suksesin e paraardhësit të tij ŠKODA Yeti.

# The Skenderbeg Square, chosen as the best public space for 2018 at the Barcelona Awards, was the introduction venue for the brand new ŠKODA Karoq.

> Scanderbeg Square, chosen as the Best Public Space for 2018 at the 2018 Barcelona European Awards, the place where a good part of Albania's modern history was written and is preserved. "A square as monumental as incidental, informal and relaxing" – as labeled by Dutch architecture critic Hans Ibelings.

Scanderbeg Square is the most central space of Tirana, the place where Albanians have rallied in revolts or celebrations, religious commemorations or sports events, became on February 13, 2018, the place to uncover the newest model of the Czech brand, the new ŠKODA Karoq.

A large green dome very close to the national history museum drew the attention of passersby in the square as well as of drivers on the Durrës and Kavaja Streets. Guests had the opportunity to look from up close for the first time at the successor of the ŠKODA Yeti and the older sibling of the ŠKODA Kodiaq, the new ŠKODA Karoq SUV.
In his opening remarks, the General Director of Porsche Albania presented an overview of the main achievements of the past year. "Again, Porsche Albania with all of its brands has managed to maintain first place in the new vehicle market in Albania. Approximately 1 out of every 3 new cars came out of our showrooms, with a total of 858 customers taking their work or dream vehicle from Porsche Albania."
Mr. Bledar Kozma, director of the ŠKODA brand at Porsche Albania spoke about the new model and said among other things, "The Karoq is an entirely new car. With its dynamic design and crystal elements, it is the latest product of the latest ŠKODA design philosophy."

The introduction of the new elements in design, the engines and the prizes awarded to the model then opened the way for the protagonist of the evening, the ŠKODA Karoq.

After the unveiling, those present had the opportunity to see from up close the model that promises to continue the success of its predecessor, the ŠKODA Yeti.

Historia jonë ka nisur me një biçikletë dhe si e tillë ka qenë ngushtësisht e lidhur në vazhdimësinë e saj me sportin e ciklizmit. Sport ky i cilësuar si më popullori në botë dhe i pari me përhapjen më të madhe në rang ndërkombëtar.

Ishte 19 Maj që shënoi startimin e turit të 75-të Ciklistik në Shqipëri, ku si prej disa vitesh tashmë, e vazhduam traditën e mbështetjes si partnerë në lëvizshmëri.

6 ŠKODA Fabia morën detyrën e rëndësishme të shoqërimit të çiklistëve në turin e tyre impenjativ, ku Michele Gazzara ia doli që të arrinte fitoren në mesin e 76 pjesëmarrësve të tjerë në garë, që vinin nga 15 kombësi të ndryshme.

Jo më kot u cilësua edhe si aktivitet promovues i mikpritjes dhe i natyrës shqiptare duke qenë se gjatë intinerarit të turit, 75 çiklistët e huaj dhe shqipëtarë kaluan në disa nga qytetet më të rëndësishëm të vendit tonë.

E kush më mire se modelet Fabia për të qenë pjesë e një aktiviteti të tillë. Shpesh mjaftojnë pak gjëra për ta bërë jetën tone më të lehtë dhe më të bukur. Kjo vlen për modelet Fabia, të cilat nuk kaluan pa u vënë re si për dizajnin estetik ashtu edhe për detajet “Simply Clever”. Shpirti rinor, i shkathët dhe dinamik i modeleve bënë një përfaqësim absolutisht të denjë të markës.

Ngjarje të tilla ne i shohim si kujtesë për rolin thelbësor që luan sporti duke ndihmuar në rritjen e vetëvlerësimit dhe në aspektin e të jetuarit shëndetshëm. Vendosmëria dhe pasioni i këtyre të rinjve janë një premtim i gjërave që do të vijnë. Kush e di! Ndoshta një ditë do të bëhemi pjesë e tureve botërore.

Përveç kësaj, dhënia e biçikletës në vetvete, ka në thelb pak nga filozofia jonë ŠKODA. Gjithçka nisi me një dëshirë të fokusuar për t’i bërë gjërat që të ecin përpara, ashtu sikurse në një biçikletë, për të ruajtur balancën, duhet të vazhdosh lëvizjen përpara. Një ëndërr që nisi me një biçikletë, vazhdoi me një motoçikletë derisa krijuam makinën e parë dhe nuk do të ndalemi me kaq. Ajo që do të na shoqërojë gjithmonë është lidhja e fortë me origjinën…

# 75 vite në ekuilibër

## ŠKODA mbështet turin e 75-stë Ciklistik të Shqipërisë.

# 75 years in balance

## ŠKODA supports Albania's 75th Cycling tour.

> Our story began with a bicycle and, as such, it was closely linked through history with the cycling sport. It is considered the most popular in the world and the first with the largest international spread.

May 19 marked the start of the 75th Cycling Tour in Albania, where we continued the tradition of supporting it as the mobility partners as we have been doing for a number of years now.

6 ŠKODA Fabia took on the important task of accompanying cyclists in their demanding tour, with Michele Gazzarra managing to win among 76 other participants from 15 different nationalities.

It was also considered an event promoting Albanian hospitality and nature, given that during the itinerary of the tour, the 75 foreign and Albanian cyclists went through some of the most important cities of the country.

Who else better than the Fabia model to be part of such an activity! Sometimes, it takes few things to make our life easier and prettier. That applies to the Fabia model too, which managed to draw attention both in terms of aesthetic design and in terms of the "Simply Clever" details. The youthful, agile and dynamic spirit of the models makes an absolutely dignified representation of the brand.

We view such events as a reminder of the essential role that sport plays, helping develop self-confidence and in terms of healthy living. The determination and passion of these young people are a promise of things to come. Who knows? Maybe one day we'll become part of global tours.

Besides, riding a bicycle on its own contains some of our ŠKODA philosophy. Everything began with a desire focused on making things move forward, just like on a bicycle, you need to keep moving forward in order to maintain balance. Things continued with a motorcycle until we created the first car and we will not stop there. What will always accompany us is the strong connection to our origins …

# GTI

## PASSION.FAMILY.FRIENDS.

## 2018

## WÖRTHERSEE

# Wörthersee Treffen

'Wörthersee Treffen' është festivali i përvitshëm Volkswagen në Austri, ku në vend të muzikë, makinat janë herojtë e skenës. Edicioni i këtij viti u mbajt gjatë datave 9-12 Maj.

Ashtu si vitet e mëparshme, lista e makinave të ekspozuara ishte unike. Golf GTI të modifikuara në krahë të Golf MK2 të pajisura me mbrojtje të përshtatshme për gara.

Makina të vjetra dhe ato të epokës vazhduan të korrnin sukses edhe në këtë edicion. Volkswagen Bulli me gjysëm kabinë dhe Golf MK1 me amortizator të ulur, parakaluan përballë modeleve të tilla si Golf GTI TCR 290 KF.

Vendndodhja

Kornizuar nga male të lartë, qyteti me shumë diell në jug të Austrisë, Reifnitz – në brigjet e liqenit Wörthersee - është vendtakimi i përvitshëm i entuziastëve Volkswagen.

Prania zyrtare Volkswagen

Edhe pse të pranishëm me modele dhe programe të ndryshme, prezenca zyrtare e markës, nuk del në plan të parë, pasi i gjithë takimi është një festë e madhe për markën që organizohet nga klientë pasionantë.

Wörthersee Treffen the annual Volkswagen festival in Austria where instead of the music, the cars are the heros. This year the meeting was set on 9-12 May 2018.

As every year the car lineup at this festival was unique. Sportly modified Golf GTI standing next to a race cage equiped Golf MK2.

Old and vintage cars continued to be a great hit in this year edition. Semi cabin Volkswagen Bullie and low susspenssion Golf MK1 paraded alongside a modified Golf GTI TCR 290 HP.

Location

Nestled in the mountainous and sun-bathed south of Austria, Reifnitz - on the shore of the Wörthersee lake - is the annual meeting point of the Volkswagen Brand enthusiast.

Volkswagen official presence

Despite being present with models and different programs, Volkswagen offical presence goes unfelt and the whole activity is a celebration of the brand organized by passionate clients.

SSION.
AMILY.
NDS.

olkswagen

PASSION. FAMILY. FRIENDS.

GTI
FRIENDS.

# Full Moon!

**Deri më 2022 grupi Volkswagen pritet të investojë 34 miliard Euro në e-lëvizshmëri. Marka 'Moon' dhe 'Moon City', platforma inovacioni në Salzburg, do të shënojnë një epokë të re në infrastrukturën e karikimit.**

*In the period to 2022, the Volkswagen Group will invest around 34 billion euros in e-mobility. The MOON brand throughout Austria, and the MOON CITY innovation hub in Salzburg, mark the start of a new era in innovative charging infrastructure solutions.*

Hëna ka qenë gjithmonë simbol i ndryshimit, sprovave të palodhura dhe përpjekjeve për sukses. Në vitin 1969, Neil Armstrong u bë personi i parë që shkeli në hënë dhe dy vjet më vonë, automjeti i parë hënor, Automjeti Shëtitës Hënor, u çua në hënë nga Apollo 15. Peshonte 210 kg dhe përbëhej nga një kornizë alumini me dy sedilje, një marsh kontrolli dhe katër rrota të drejtuara nga qendra.

"Në fakt, NASA po përdorte konceptin original të Ferdinand Porsche nga viti 1990, modeli legjendar Lohner Porsche me motorë të montuar në qendër – i cili ishte modeli i parë në botë me të gjitha rrotat aktive", vë në dukje Wilfried Weitgasser, Drejtor Menaxhues i degës Allmobil të Porsche Holding.
Novacioni, fryma e krijimit dhe ndryshimi ishin kryefjala e ditës. "Tani është radha jonë për të hyrë në një epokë të re," thotë Weitgasser. Ndryshimet që janë përpara do të kenë të bëjnë me një përkushtim të qartë për lëvizshmërinë e qëndrueshme dhe energjinë e rinovueshme," dhe marka e re MOON e pasqyron këtë.

**e-lëvizshmëria në ditët tona dhe epokën tonë**
"Pikërisht në këtë moment, kemi shansin unik për të ndihmuar që t'i japim formë të ardhmes së e-lëvizshmërisë," thekson Walter Huber, bashkë-drejtues (sëbashku me Robert Steinböck) i projektit MOON.
MOON është marka e re e Allmobil që synon drejt zgjidhjeve të reja energjike të infrastrukturës për klientët dhe klientët tregtarë, duke mbuluar të gjitha tregjet e automjeteve. MOON premton të sjellë në jetë çdo aspekt të e-lëvizshmërisë për klientët. Do të përfshijë materiale informative, aplikacione dhe reklama, një përvojë të pasur për klientët në pikat e shitjes, prova drejtimi të mjeteve dhe blerje të e-automjeteve. Portofoli i produktit përfshin edhe një ekosistem të plotë me wall box, njësi karikimi në shtëpi dhe sistem fotovoltaik për prodhim energjie. Po ashtu, do ofrohen financim nga Porsche Bank, montim sistemi, këshilla të gjithanshme për menaxhim të optimizuar të energjisë, të gjitha nga një burim i vetëm, pra MOON.
Porsche Wels, shitësi i autorizuar i parë neutral për nga CO2, është krijuar si një vendndodhje pilot. Në Bavari, qendra e automjeteve të përdorura të VGRD në Eching ka ofruar MOON prej fillimit të vitit, me ndihmën e një sistemi fotovoltaik maksimal prej 100kW. Në fund të vitit do të pasojë një pikë karikimi prej 350 kW, një projekt ekspozimi për Gjermaninë. Por ky është vetëm fillimi. "Gjatë dy viteve të ardhshme, do të pajisim e-partnerë të përzgjedhur dhe 16 koncesionarë PIA me paketa të posaçme karikimi," thotë Robert Steinböck. "Me fjalë të tjera, do t'i kthejmë koncesionarët tanë në stacione karikimi kompetent," vazhdon ai. "Është hapi i parë për ndërtimin e rrjetit tonë të stacioneve të karikimit, i cili do të na bëjë edhe më tërheqës për klientët."
Sistemet fotovoltaike tek koncesionarët do të ndihmojnë për të përmbushur nevojat e stacioneve për energji, meqenëse synimi është që këto pika të jenë të vetëmjaftueshme. Energjia e papërdorur do të përdoret brenda koncesionarëve, çka do të çojë në uljen e kostove të energjisë dhe do të sigurojë qendrueshmëri dhe efiçencë.

**Projekti flamurmbajtës**
MOON CITY, një projekt flamur-mbajtës madhor do të jetë operacional në fillim të vitit që vjen. Do të jetë i vendosur në zemër të Salzburgut, në adresën Sterneckstraße 28, e cila deri kohët e fundit ishte një pikë e Porsche.
Do të jetë një dyqan kryesor me të gjitha produktet MOON CITY, ku ekspertët do të ofrojnë këshilla për banesat dhe kompanitë konsumatore. "MOON CITY do të jetë edhe më shumë se kaq: do të jetë një qendër ekselence për lëvizshmëri dhe për rrjetëzim, ku cilido mund të vijë dhe të zbulojë teknologjitë e reja," shpjegon Menaxheri i Projektit Leo Fellinger, ekipi i të cilit aktualisht po punon fort për të ngritur MOON CITY.

MOON EXPERIENCE për shembull, do të ofrojë një përzierje mbresëlënëse të realiteteve të theksuara, të prekjes dhe virtuale, për t'u ofruar vizitorëve një përvojë të gjallë të teknologjive të reja.

The moon has always been a symbol of change, tireless endeavour and striving for success. In 1969 Neil Armstrong became the first person to set foot on the moon, and two years later the first lunar vehicle, the Lunar Roving Vehicle, was taken to the moon by Apollo
15. It weighed 210 kg and consisted of an aluminium frame with two seats, a control joystick and four hub-driven wheels.

“NASA was, in fact, using Ferdinand Porsche’s original concept from 1900, the legendary Lohner Porsche with hub-mounted motors – which was actually the world’s first all-wheel drive vehicle”, notes Wilfried Weitgasser, Managing Director of Porsche Holding subsidiary Allmobil. Innovation, pioneering spirit and change were the order of the day. “Now it is our turn to embark on a new era”, says Weitgasser. The changes that lie ahead will involve a clear commitment to sustainable mobility and renewable energy, and the new MOON brand reflects that.

**e-mobility in our day and age**
“**AT THIS** precise moment we have a unique opportunity to help shape the future of e-mobility”, stresses Walter Huber, joint head (with Robert Steinböck) of the MOON project. MOON is the new Allmobil brand geared to charging infrastructure solutions for consumers and commercial customers, covering all vehicle brands.

MOON promises to bring every aspect of e-mobility alive for customers. It will include information materials, apps and advertising, a rich customer experience at the point of sale, test drives and e-vehicle purchasing. The product portfolio also includes a complete ecosystem with wall box, home charge storage unit and photovoltaic system for power generation. Also available are Porsche Bank financing, system assembly and comprehensive advice and support for optimised energy management, all from a single source, namely MOON. Porsche Wels, the first $CO_2$ - neutral dealership, has been set up as a pilot location. In Bavaria, VGRD’s used vehicle centre in Eching has been offering MOON since the start of the year, with the help of a 100-kW-peak photovoltaic system. A 350 kW charging station will follow at the end of this year, a showcase project for Germany. But that is just the start. “Over the next two years, we will equip selected e-partners and 16 PIA dealerships with individually tailored charging packages”, says Robert Steinböck. “In other words, we will be turning our dealerships into competent e-filling stations”, he goes on. “It is the first step in building our own e-filling station network, which will make us even more attractive to customers.” Photovoltaic systems at dealerships will help meet the charging stations’ power needs, as the goal is for locations to be largely self-sufficient. Unused power will be used within dealerships, which will help reduce energy costs and ensure sustainability and efficiency.

**Flagship project MOON CITY,** a high-profile flagship project, will go live early next year. It will be situated right in the heart of Salzburg, at Sterneckstraße 28, which until recently was a Porsche location. It will be a flagship store with all MOON CITY products, where experts will provide advice to consumer households and companies. “MOON CITY will be even more than that: it will be a centre of excellence for mobility and a place for networking, where anyone can come and discover the new technologies”, explains Project Manager Leo Fellinger, whose team are currently working hard on setting up MOON CITY.

MOON EXPERIENCE, for instance, will provide a remarkable mix of augmented, haptic and virtual realities, to provide visitors with a vivid experience of the new technologies.

MOON

**Ecja në Hënë**

“MOON POWER”
Zgjidhje të plota për ngritjen e një infrastrukture të gjerë e-lëvizshmërie

“MOON CITY”
Qendër e ekselencës dhe novacionit për lëvizshmërinë e re

“MOON EXPERIENCE”
Përvojë interaktive që ekspozon e-lëvizshmërinë dhe lëvizshmërinë e rrjetëzuar dhe autonome

QENDRA E NOVACIONIT SALZBURG
Kërkim & zhvillim me partnerë nga bota e teknologjisë dhe industrisë

QENDRA STARTUP SALZBURG
Testimi i novacioneve, projekteve pilot dhe prototipeve

RIPARIM BATERISH
Qendër riparimi për bateri të voltazhit të lartë

TRANSFORMIM
Rigjenerim dhe elektrifikim i makinave historike

**Doing the Moon Walk**

MOON POWER
Complete solutions for the setting up of an extensive e-mobility infrastructure

MOON CITY
Centre of excellence and innovation for New Mobility

MOON EXPERIENCE
Interactive experience showcasing e-mobility and networked and autonomous mobility

INNOVATION HUB SALZBURG
Research & development with partners from the worlds of technology and industry

STARTUP HUB SALZBURG
Testing of innovations,
pilot projects and prototypes

BATTERY REPAIR
Repair centre for high-voltage batteries

TRANSFORMATION
Restoration and electrification of historic cars

Më shumë se thjesht një stacion karikimi, “MOON POWER” do të jetë një ekosistem tërësor energjie

More than just a charging station: MOON POWER is a comprehensive energy ecosystem.

Ju që shihni orën,
bëni pak pushim.
Audi i ri A6 me paketën 'city assist' monitoron
në mënyrë të vazhdueshme ambientin përreth makinës.
Funksion veçanërisht i rëndësishëm në rrugët e
ngarkuara të qytetit, ku makina ju paralajmëron për
makinat e tjera atëherë kur keni më shumë nevojë, prsh
gjatë daljes nga parkimi. Ndoshta hera e vetme kur
togfjalëshi "të shijosh udhëtimin në qytet" merr kuptim.
#KohëPërVeten
Kjo është koha Juaj. 'Audi is more'
Audi i ri A6.
PORSCHE
ALBANIA
Autostrada Tiranë-Durrës Km. 7
www.audi.al
Tel.: +355 (0) 69 20 57 232